



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Lënda: Kthim Përgjigje

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Në përgjigje të kërkesës suaj për dhënien e informacionit në lidhje me ankesën me nr. 218 prot., datë 29.01.2018 të Qendrës “Res Publica” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare, Ju informojmë si më poshtë:

Pranë Bashkisë Elbasan është depozituar kërkesa me nr. 237 prot., datë 12.01.2018, e Qendrës “Res Publica” në të cilën kërkohej informacion dhe dokumentacion në lidhje me aktivitetin për fëmijët e shtresave në nevojë, në kuadër të festave të fundvitit.

Me tonën nr. 237/1 prot., datë 12.01.2018, kemi informuar Qendrën “Res Republica” se: Bashkia Elbasan ka një përvojë shumë vjeçare bashkëpunuese me aktorët lokale midis tyre dhe subjektet ekonomike, për mbështetjen e shtresave në nevojë. Këtë fundvit është vijuar me organizimin e aktivitetit me fëmijët dhe familjet më në nevojë, kryesisht të komuniteteve Rome, Egjiptiane por jo vetëm, me qëllim mbështetjen e këtyre familjeve dhe argëtimin e fëmijëve. Ky aktivitet u realizua falë bashkëpunimit midis drejtorive të Bashkisë Elbasan, Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social, Agjensia e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave (A.T.V.M.A) dhe bizneseve lokale (emrat e të cilëve për arsye etike nuk mund ti bëjmë publike, pa miratimin e tyre)

Nisur nga një traditë tashmë disavjeçare bashkëpunimi, për mbështetjen e shtresave në nevojë në prag festash, bizneset dhe këtë fundvit kanë shprehur dëshirën për të dhënë kontributin e tyre **(subjekteve nuk i është bërë ftesë, pasi ato janë paraqitur vetë për të dhënë kontributin e tyre)**

Gjithashtu është sqaruar se subjektet kanë kontribuar me 80 pako ushqimore të cilat i janë dhuruar 80 familjeve pjesëmarrëse në aktivitet **(pra nuk janë mbledhur të ardhura dhe nuk nuk janë kryer shpenzime nga ana e stafit të bashkisë)**.

Pas kthimit të përgjigjes sonë me nr. 237/1 prot., datë 12.01.2018, nga Qendra “Res Publica”, nuk ka ardhur asnjë ankesë apo kërkesë tjetër në rrugë zyrtare apo në adresat e email, për kërkim dokumentacioni.

Bashkëngjitur: Kthim Përgjigjen me nr. 237/1 prot., datë 12.01.2018.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.